



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 04.08.2022

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në VKM nr. 35, datë 19.01.2022 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si mëposhtë vijon :

I. DREJTORIA E AUTORIZIMIT TË PAGESAVE

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b

Detyrat kryesore:

- Përlllogarit shumën për t’u paguar bazuar në dokumentacionin e dërguar në SAPI (Sektori i Autorizimit të Pagesave IPARD);
- Përgatit autorizimin e tabelave me zërat e investimeve bazuar në faturat, ofertat dhe kontratat e dërguara në SAPI;
- Merr pjesë në trajnimet e miratuara nga eprorët;
- Kontrollon listën e projekteve të dërguara nga Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, nëse përputhen me dokumentat që i bashkëngjiten projektit;
- Mban dhe kompletion regjistrin e hyrje-daljeve të dosjeve të aplikantëve në Sektorin e Autorizimit të Pagesave;
- Përditëson regjistrat e sektorit.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

- Diplomë e nivelit “Master Profesional”, në Shkenca Bujqësore, Shkenca Shoqërore, Shkenca Inxhinierike - UPT/ Shkenca e Natyrës. *(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).*
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
- Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit

- Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
- Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuri mbi ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Njohuri mbi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë;
- Njohuri mbi ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;
- Njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural,
- Njohuri mbi ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
- Njohuri mbi ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- Njohuritë mbi ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”;
- Njohuri mbi ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për RSH, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit, në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (IPARD)";

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 08.08.2022, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL